



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.63/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Bujar Muzaqi dhe Violeta Husaj Rugova anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik GI Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ( KQZ ), për shkak të parregullsive në vendvotim, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 31.12.2025, merr këtë,

**V E N D I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa Subjektit Politik GI Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, ZP.A.nr.63/2025, e datës 30.12.2025, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në vendvotim, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 28 Dhjetor 2025.

**A r s y e t i m**

Me datën 30.12.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik GI Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, në të cilën pretendohet se gjatë numërimit në komunën e Novobërdës, përfaqësuesit e Listës Serbe si vëzhgues kanë fotografuar çdo fletëvotim që vihej në ekranin e madh. Parashtruesi i ankesës thekson se janë ankuar tek kryetari Selim Mehmeti nga KKZ dhe ai është përgjigjur duke thënë se kanë të drejtë fotografimi çdo parti prezentë. Sipas parashtruesit të ankesës shpërndarja e materialit publik të ndjeshëm përmes telefonit privat është e paligjshme sipas kodit të procesit zgjedhor. Tutje, parashtruesi i ankesës shton se njëkohësisht në disa fletëvotime ka lloje të ndryshme shenjash si vija të gjata afër kutive dhe brenda vetë kutive zemra me ngjyra të ndryshme, kështu kanë shënuar votuesit e tyre dhe kur kanë ndaluar pas orës 15:00, pasi kjo vazhdoi nga ora 12:30 deri në 15:00, pastaj filluan të shënojnë dhe shkruajnë fletëvotimet e tyre në letër. Kjo është një praktikë që zbatohet në komunën e Novobërdës por edhe një praktikë në të gjitha vendet ku shumica e votuesve janë nga komuniteti serb. Andaj, parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP që të reagoj dhe ta ndaloj këtë lloj shkeljeje të mbrojtjes së materialit zgjedhor. Parashtruesi i ankesës pretendon se ka bashkangjitur në ankesë dëshminë e vëzhguesit përpara Lëvizjes " Za Slobodu, Pravdu i Opstanak " si dhe dëshminë e përfaqësuesit të SPO-së përpara KKZ-së, përfaqësuesi që u ankua disa herë kryetarit mirëpo të njëjtat nuk janë të bashkangjitura.

Në përgjigje në ankesë Srpska Lista, në lidhje me pretendimet ankimore për fotografim të fletëvotimit, sqaron se është detyrë e vëzhguesve të regjistrojnë çdo fletëvotim të dyshimtë për të evidentuar kohën dhe numrin e fletëvotimit, duke siguruar kështu dëshmi për nevojat e një ankesë të mundshme në PZAP. Vëzhguesit kanë regjistruar fletëvotimet e dyshimta në përputhje me rregullat dhe me miratimin e personit të autorizuar kompetent në Qendrën për Numërimin e votave dhe në përputhje me rregullat e KQZ. Më tej në përgjigje theksohet se shikimi i fletëvotimit në ekran është i dukshëm edhe në raporte në mediat, dhe se nuk bëhet fjalë për nxjerrje të materialit ndjeshëm, siç pohon pa baza paditësi. Kërkojnë nga PZAP-i që ta hedhë poshtë ankesën si të pabazuar.

Në përgjigje në ankesë KQZ, sqaron se ka kontaktuar me KKZ e komunës së Novobërdës. Sipas komunikimit me QKN Novobërdë me datë 29.12.2025, në pjesën e vëzhguesve ku janë të vendosur televizorët, mirëpo jo te tavolinat e numërimit vëzhguesit e subjekteve politike kanë marrë shënime me laps kimik dhe ndonjëri prej tyre ka bërë foto të televizori e jo te tavolina e numërimit, nuk është e ndaluar me rregulla ligjore. Asnjë vëzhgues i subjekteve politike tjera nuk janë ankuar. Vëzhguesit e subjektit politik GISPO Milan Dabic ka ardhur me qëllim të caktuar ta pengojnë punën në QKN Novobërdë dhe ka tentuar të ndërhyjnë disa herë te tavolinat e Ekipit të Numërimit. Pretendimet se ka shenja në fletëvotime nuk qëndrojnë, sepse kjo nuk është vërejtë në librin e evidencës së QKN. Në lidhje me pretendimet e palës ankuese se në disa fletëvotime janë vizatuar shenja të ndryshme, si vija të gjata pranë katrorëve dhe brenda vetë katrorëve zemra me ngjyra të ndryshme (kështu i kanë shënuar votuesit e tyre), në procedurën e votimit dhe numërimit në vendvotim, të miratuar nga KQZ, janë paraparë shembujt e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova relevante, siç janë; Mostra të fletëvotimeve të shënuara, numrin e vendvotimit për fletëvotimet e pretenduara, librin e evidencës në QKN, dhe prova të tjera të cilat do të mund të dëshmonin shkeljet e pretenduara. KQZ, njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, momentalisht gjendet në QKN të komunës së Novobërdës, mirëpo pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve-QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën, përgjigjet në ankesë, vëren se ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë, vlerësoj se pretendimet ankimore të subjekti politik GI Za Slobodu, Pravdu i Opstanak janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj si të pabazuara, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohen se ka pasur parregullsi në qendrën e numërimit të cekura në ankesë.

Paneli vëren se sipas komunikimit të KQZ-së, me QKN Novobërdë më datë 29.12.2025, QKN në Novobërdë e ka njoftuar KQZ-në se *“Në pjesën e vëzhguesve ku janë të vendosur televizorët, mirëpo jo te tavolinat e numërimit vëzhguesit e subjekteve politike kanë marrë shënime me laps kimik dhe ndonjëri prej tyre ka bërë foto të televizori e jo te tavolina e*

*numërimit, nuk është e ndaluar me rregulla ligjore, dhe se asnjë vëzhgues i subjekteve politike tjera nuk janë ankuar..., nuk ka vërejtje në librat e evidencës së QKN.”*

Duke marrë parasysh arsyet e dhëna më lart, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë të qartë përcaktohet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1, të Ligjin Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
ZP.Anr.63/2025, datën 31.12.2025

Kryesues i Panelit  
Hajriz Hoti



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.